

INFRAKOS S.H.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.

Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

E marta pranuar Received Prilazhenje		
05.05.2021		
Nr. punuese Work unit Red. jed	Nr. No. Br.	Shtojca Supplement Prilog
1	404	-



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë - Prishtinë

DATE/A:	16.10.2020
REFERENC-Ë:	138/2020
PËR/ZA/TO:	Pronarë, posedues dhe shfrytëzues të asetit të Trashëgimisë Kulturorë
CC:	znj. Vjollca Aliu, Drejtoreshë DTK, MKRS z. Iber Alaj, UD Sekretar i Përgjithshëm në MKRS
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Edona Durguti, Drejtoreshë QRTK-Prishtinë
NGA/OD/FROM:	Yllka Mustafa, Zyrtare Ligjore, QRTK-Prishtinë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prishtinë duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë dhe mbështetur në Nenin 14, paragrafi 2.5 të Rregullores Nr. 06/2017, Për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturorë, Vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Cilësinë e Institucionit Kompetent ju njofton, Ju si pronarë, posedues dhe shfrytëzues të asetit të Trashëgimisë Kulturorë që ndërtesa:

Stacioni i Trenit, - Prishtinë,

është pjesë e Regjistrit të Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme në kategorinë e Trashëgimisë Arkitekturore, miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vendimi nr. 129/2020, datë 10.10.2020, me numër unik 3402 dhe numër rendor 590.



Për: Z. Shpend Ahmeti
Kryetar i Kuvendit Komunal Prishtinë

Nga: Zymer Zekaj
UD. i Kryeshefit Ekzekutiv të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës
Sh.A. - INFRAKOS

Lënda: Kërkesë për lirim nga tatimi mbi pronën e INFRAKOS-it,

I nderuari z. Kryetar,

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh. A. – "INFRAKOS" Sh.A, është ndërmarrje publike përgjegjëse për menaxhimin me Infrastrukturën Hekurudhore të Kosovës përfshirë këtu edhe territorin e administruar nga Kuvendi Komunal i Pejës. Për informimin tuaj mbështetur në ligjin Nr.02/L-88 për trashëgiminë kulturore, infrastruktura hekurudhore, respektivisht objektet e INFRAKOS-it në territorin e komunës tuaj kanë statusin e objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.

Për më tepër, bazuar në Nenin 5, pika 5.3 thuhet se: "Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme lirohet nga tatimi mbi pronën, në pajtim me këtë ligj".

Andaj, mbështetur në ligjin dhe nenin e sipër cekur kërkojmë nga ju që të shqyrtoni kërkesën tonë për lirim nga tatimi në pronë të të gjitha objekteve të listuara të cilat e kanë statusin e objektit në mbrojtje të trashëgueshmes kulturore.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë keni numrin e vendimeve nga data: vendimin nr. 98/2014 të datës 01.10.2014 deri më vendimin nr. 189/2020 të datës 10.10.2020 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes të cilit aprovet Regjistri i Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përkohshme, në të cilën janë listuar objektet në vijim të cilat kanë fituar statusin e objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në komunën e Prishtinës:

- Nr.unik 3402 - Stacioni i Trenit Prishtinë,
- Nr.unik 3402 - Stacioni i Trenit në Vranidoll.

Duke ju falënderuar për bashkëpunim dhe mirëkuptim, ju lutem pranoni përshëndetjet e mia më të sinqerta.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 98 /2014

Datë: 01.10.2014

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Memli Krasniqi, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 (shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe u mbështetur në nenin 2 (paragrafi 16) dhe nenin 3 (paragrafi 5, 6, 7, 8) të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, mori këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme.
2. Lista përfshin 1441 asete të trashëgimisë kulturore në kategorinë e trashëgimisë arkeologjike me nënkategoritë monument/ansambël dhe lokalitet arkeologjik rezervat, pastaj kategorinë e trashëgimisë arkitekturore me nënkategoritë monument/ansambël, fushat e konservimit arkitekturor si dhe objektet e luajtshme.
3. Asetet e përfshira në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme do të jenë nën mbrojtje për një vit.
4. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme ka të njëjtat attribute me trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme. Po ashtu asetet e përfshira në këtë Listë e të cilat janë të mbrojtura edhe Ligj të veçantë, i kanë edhe atributet mbrojtëse në aspektin ligjor të përcaktuar me Ligjin e veçantë.

5. Këtë Vendim i bashkangjitet edhe Lista e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij vendimi
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


Arsyetimi

Propozimet e aseteve për Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme janë bërë nga Institucionet e trashëgimisë kulturore në vartësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha propozimet dhe ka rekomanduar që të aprovohet Lista me 1441 asete, mbi bazën e të cilit rekomandim është marr ky Vendim.

Vendimi i dërgohet


- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapështor
- Komunave
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore
- Institucioneve të trashëgimisë kulturore në vartësi të MKRS-së
- Pronarëve
- Agjencionit Kadastral të Kosovës
- Departamentit Ligjor
- Arkivit të MKRS-së

Memli Krasniqi
Ministër



1. - Aplikimi për mbrojtje - MOTIVI -

2.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministarstvo Kulture, Omladine i
Sporta-Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prishtinë

NJOFTIM

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prishtinë në mbështetje të nenit 4, paragrafi 7 të Ligjit Nr. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE, duke u bazuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vendimi nr. 116/2015, datë 09.10.2015, ju njofton

Ju si pronarë, posedues dhe shfrytëzues të asetit të Trashëgimisë Kulturore që ndërtesa:
Stacioni i trenit, Prishtinë

është pjesë e Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vendimi nr. 116/2015, datë 09.10.2015.

Pranoi

Emri dhe mbiemri: Valdrin Kasumaj

Nënshkrimi: [Signature]

Regjistri i Trashëgimisë Kulturore – Pikat te cilat e atakojnë
Infrakos Sh. A.

II. Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore

44	Stacioni i Trenit Pejë	1933 - 34	Pejë
185	Stacioni i Trenit Lutogllavë	1934	Lutogllavë, Pejë
331	Stacioni i trenit		
426	Stacioni i trenit	Shek. XX	Budislac, Klinë
590	Stacioni i trenit	Shek. XX	Prizren
629	Stacioni i Trenit	Shek. XX	Prishtinë
			Vrandiollë,
646	Stacioni I trenit ne Dritan (Dobroshec)	1936	Prishtinë
653	Linja hekurudhore	1936	Dobroshec,
	Drenas- Pejë		Drenas
673	Stacioni i vjetër	1943	Drenas - Pejë
	Hekurudhorë		
862	Ndërtesa e stacionit të trenit	Shek. XIX	Fushë Kosovë
876	Ndërtesa e stacionit të trenit	Shek. XIX	Ferizaj
			Gërllicë, Ferizaj

III. Kategoria: Objektet e luajtshme

204	Peshorja	1874	Muzeu i Hekurudhave	Fushë
			Fushë Kosovë	Kosovë
205	Lokomotiva me Avull	1922	Muzeu i Hekurudhave	Fushë
			Fushë Kosovë	Kosovë